



## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 23**

**Datë: 25. 2023. Ora: 13:30**

**Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë**

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ.

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 21/2023**
- 3. Raportet e Këshillave të KQZ-së**
  - **Këshilli për Operacione Zgjedhore**
    - Shqyrtimi dhe miratimi i Asgjësimit/Shkatërrimit të materialit zgjedhor të zgjedhjeve të zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan,

Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjet e parakohshme për Kuvendet e Komunave: Zveçan dhe Leposaviq

- Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për realizimin e planit të punës të KQZ-së si dhe shtojca - “ Raport i Realizimit të Planit të Punës, për periudhën janar-qershor 2023

- **Këshilli për Buxhet dhe Financa**

- Shqyrtimi dhe miratimi i raportit financiar për periudhën janar- qershor 2023
- Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të shpenzimeve të derivateve janar- qershor 2023

- **Këshilli për personel**

-Njoftim nga këshilli për personel

## **Të ndryshme**

---

### **1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniq, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

Fillimisht, kryetari Kreshnik Radoniq paraqiti rendin e takimit, ndërsa i pyeti anëtarët nëse, ata kanë diçka për të shtuar a propozuar lidhur me rendin e ditës. **Sami Hamiti**, tha se pasi që ka ardhur një material nga zyrtarja e KK-së së Prishtinës, këshilli ka mbajtur takimin dhe kërkojmë që të futet në rend dite “kërkesa” për një zëvendësim të asamblistit në këtë komunë.

Në vazhdim, me 10 vota për u miratua procesverbali nga mbledhja nr. 21.

### **2. Raportet e Këshillave të KQZ-së**

#### **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

**Shqyrtimi dhe miratimi i Asgjësimit/Shkatërrimit të materialit zgjedhor të zgjedhjeve të zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjet e parakohshme për Kuvendet e Komunave: Zveçan dhe Leposaviq:**

**Arianit Elshani**, tha se Këshilli a shqyrtuar këtë kërkesë të Sekretariatit për asgjësim të materialit për zgjedhjet e fundit. E keni raportin të cilit, ia kemi bashkangjitur edhe dy shkresa, në nga zyra e Prokurorisë së Shtetit dhe një nga PZAP se nuk është duke u zhvilluar asnjë procedurë lidhur

me këtë proces zgjedhor dhe kutitë e votimit. Materiali mund të asgjësohet dhe, ne e rekomandojmë këtë...

Me 10 vota për, u miratua ky rekomandim.

**Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për realizimin e planit të punës të KQZ-së si dhe shtojca - "Raport i Realizimit të Planit të Punës, për periudhën janar-qershor 2023":**

Arianit Elshani: E kemi shqyrtuar edhe këtë pikë dhe, ky raport do duhej të ishte bashk me rishikimin e planit të punës kur e miratuam para tri javësh. Keni grafikonin statistikor, secilin aktivitet të listuar, realizimin dhe mos realizimin e planit. Ky plan, është në proces të realizimit në masën 58%, dhe se janë realizuar 27 % e aktiviteteve, dhe 15% janë në realizim e sipër. Kuptohet, sipas planit të paraparë. Disa aktivitete, do të fillojnë në shtator dhe tetor. E kemi ba rishikimin, dhe ne si këshill shqyrtimin dhe analizën e kemi bërë. Rekomandojmë që ky raport të miratohet...

Me 10 vota për, u miratua Raport i Realizimit të Planit të Punës për periudhën janar-qershor 2023.

**Këshilli për Buxhet dhe Financa**

Shqyrtimi dhe miratimi i raportit financiar për periudhën janar- qershor 2023 dhe, i shpenzimeve të derivateve: janar- qershor 2023

Gordana Llaban, tha se këshilli ka mbajtur takimin e 9-të dhe në këtë takim kemi shqyrtuar, për mendimin tim, dy pika interesante: njëra që ka të bëjë me raportin financiar për periudhën janar- qershor (2023), dhe tjetra me raportin e shpenzimeve të derivateve për periudhën janar- qershor të këtij viti. Sipas ligjit, në KQZ i janë ndarë 6. 397,140 euro. Këto mjete, lidhur me funksionin e institucionit janë ndarë në shifra të caktuara: për paga, shërbime, subvencione dhe transfere, derivate etj. ( ndarjet buxhetore dhe shpenzimet janë paraqitur në raportin financiar). Rekomandojmë që të aprovohen këto dy raporte.

Sami Kurteshi, tha se për shërbime dhe mallra janë shpenzuar diku rreth 20%, dhe për shërbime komunale 14%. A mund të na shpjegoni se pse për gjashtë muaj po më duket nivel shumë i ulët i përdorimit të mjeteve që janë kërkuar nga KQZ, dhe janë ndarë...

**Burim Ahmetaj**, shpjegoi se KQZ është në mesin e realizimit të shumë projekteve. Është nivel i ulët, por buxheti si tërësi është ri dizajnuar dhe s'kemi pasur kapacitete, sidomos në procesin zgjedhor që e kishim në zgjedhjet e 23 prillit. Por, janë në raport shpenzimet dhe, shumë projekte janë në proces. Mirëpo në tre mujorin e katërt, do ta dimë më saktësisht se sa është niveli i shpenzimeve...

**Sami Kurtesh**, tha se auditori megjithatë ka konstatuar se mjetet e shpenzuara që janë ndarë janë të vogla. Shpenzimi i mjeteve nuk bëhet me nikoqirllëk, dhe nuk është i kënaqshëm...

**Sami Hamiti**, tha se në këshill i kemi trajtuar pikërisht mallrat dhe shërbimet dhe shërbimet komunale. Pavarësisht, ne kishim zgjedhjet në veri, ato kanë ndodhë...Po ashtu, tash e kemi edhe auditimin e partive politike, dhe ky shpenzim do të ndodh. Me shpenzimeve me mallra, nuk jemi keq por, problemi i planifikimit të cilin e kemi diskutuar, si çështjet e shërbimeve komunale etj. Kjo që po thotë z. Kurteshi, është e vërtetë ! Auditori vjen dhe thotë se, i ke planifikue 30 mijë, e i ke shpenzue 10 mijë, pra je planifikues i keq...! Por kjo nuk qëndron për arsyet që i thash, dhe ky raport duhet të votohet...

**Alban Krasniqi**: Raporti në tërësi, është pasqyrë që reflekton atë që kemi shpenzue sipas kërkesave, sipas planifikimeve. Pra, shpenzimet që i ka Sekretariati, KQZ, buxheti për zgjedhjet dhe programi për partitë politike. Mendoj se shqetësues është niveli i shpenzimit të mallrave dhe shërbimeve se, shpenzime kapitale nuk kemi. Por, mund të bëjmë shpërndarjen, të shihet se cili departament ka nevojë, ku të shpërndahen shpenzimet...Të shohim ku ka ngecje: ka dështue furnizimi me kuti votimit , pra do ishte mirë që të angazhohen edhe këshillat dhe të shihen pasqyrat e planifikimit...

Mendoj se, tha z. Krasniqi, deri në shtator është mirë që të shohim se ku jemi sepse, pastaj limitohet koha, tenderimet hyjnë në procese të kufizuara dhe nuk mund t'i bëjmë...

### **Këshilli për Çështje Ligjore**

Njoftim nga këshilli për personel

**Sami Hamiti**: Në mbledhjen e tetë, e kemi shqyrtuar kërkesën e KK-së së Prishtinës për një zëvendësim të asamblistit në këtë komunë, dhe kërkesa ka qenë në rregull, dokumentacioni i kompletuar dhe

mendojmë se kjo është në rregull, edhe ligjërisht. Prandaj, këshilli rekomandon që ky zëvendësim të bëhet sot, në këtë takim...

Rashit Gashi, nga VV-ja ka dhënë dorëheqje dhe, në radhë është Edmond Azemi i cili, ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore. Kandidati, po ashtu, është nga Lëvizja “Vetëvendosje!”, rekomandojmë këtë zëvendësim...

**Kreshnik Radoniqi**: Kush është për...?

Me 10 vota të të pranishmëve, miratohet ky rekomandim për zëvendësim të asamblistit.

**Sami Kurteshi**, në kontekst tha se, sa mbaj mend ky është rasti i parë ku kanë kaluar dy javë, prej ditës së dorëheqjes e deri sot, në ditën e miratimit! Unë, këtë rast e shoh si të dyshimte, dhe si keqpërdorim për qëllime politike nga administrata e KQZ-së. Sinqerisht, jam i interesuar me pa gjithë rastin. Ne, nuk i bëjmë në raste të tilla, zëvendësimet, më shumë se pesë ditë. Në këtë rast, kemi ngecje dhe mendoj se kjo ka “sfond politik”. Unë po e bëj këtë vërejtje që administrata, mos me e marrë rolin politik të KQZ-së. Ata, administrata është vetëm trupë profesionale...

**Sami Hamiti**, tha se nuk dua ta amnistoj askënd por, unë e kam pa gjithë rastin. Neglizhenca, ka ardhur nga komuna por jo nga administrata jonë. Sa kam pa unë, ky rast është i këtitillë. Edhe për zyrtaren tonë, edhe për ne kërkesa nuk ka ardh e komplikuar. Në këtë rast, unë nuk shoh komplikime që kanë ardhur nga administrata jonë. Në këtë temë sensitive, diskutuan edhe: Arianit Elshani, i cili ndër të tjera tha se po, letë shihet se ku kanë qenë gabimet, ngecjet etj.; Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, i cili, insistoi në dyshimet rreth neglizhimit – zhegitjeve të qëllimshme të këtij rasti. Ai, tha se “kërkoj që të dihet (nuk më interesojnë emrat dhe mbiemrat) se pse ka pasur neglizhencë – refuzim sepse, e kam ngritë javën e kaluar dhe se e kemi ngritë përsëri dhe se, tek sot është procedu...”. Sami Hamiti, ri përsëriti faktin se “problemi është brenda administratës komunale dhe jo te ne. Nuk dua ta mbrojë askënd por, janë faktet...”; Çemailj Kurtiç, gjithashtu tha se këtu nuk duhet të kemi politikë, ta politizojmë rastin. Ne dihet se çfarë trupe jemi ! Kemi dhënë edhe betimin, dhe në asnjë rast nuk duhet të bëjmë politikë. Me rastin, kryeshefi duhet të merret, ndoshta ka neglizhencë...; Kreshnik Radoniqi, tha se informacioni mbi dorëheqjen ka qenë, por unë nuk po besoj që ka pas diçka të qëllimshme. Është evidente që ka vonesa, por të diskutohet, të rregullohet komunikimi dhe të mos zgjas më kështu në të ardhmen...

### **Këshilli për personel**

Njoftim nga këshilli për personel

**Alban Krasniqi**, e informoi KQZ-në se brenda javës, maksimumi në fillim të javës mund të fillojmë me punën e grupeve për rregullat e brendshme. Gjithashtu, tha Krasniqi, kemi diskutuar edhe çështjen se si të gjejmë mekanizëm të qëndrueshëm, të përshtatshëm për zyrtarët në pozita të larta menaxheriale që pas përfundimit të mandatit të tyre, si duhet rregulluar pozicioni i tyre. Mënyrën se si të rregullohet nuk e kemi diskutuar, por jemi pajtuar që ta kemi “një model” që vlen për të gjitha rastet. Sigurisht, në bashkëpunim edhe me ekspertin do të arrijmë një model...

Në këtë pikë, e cila do të jetë edhe në ditët e ardhshme preokupim dhe shqyrtim i KQZ –së deri në finalizim, diskutuan më tej: Sami Hamiti, Arianit Elshani etj.

**Alban Krasniqi**, po ashtu e informoi KQZ – së rreth takimit me OSBE-në dhe me kompaninë që po e trajton Sofuerin. Ishte takim i gjatë, dhe po besoj që ajo që duhet të ndodh shpejt, është edhe dhënia për anëtarët e “aksesit”, por edhe me pas mundësi në çështje të tjera. Kemi bërë renditjen e aktiviteveve, dhe mendoj që gjatë këtij muaji do të kemi një intensivitet rreth kësaj çështje. Pra, kemi përpara tri procese: ato të rregullave zgjedhore, të rregullave të brendshme dhe kjo, e softuerit...

**Arianit Elshani**, në vazhdim ngriti sërish disa çështje teknike, si puna e klimës në zyre...

**Të ndryshme!**